



Republika Kosovo-Republika e Kosovës-Republic of Kosovo

Opština Štrpce  
Komuna e Shtërpçës  
Municipality of Strpce

REPUBLIKA KOSOVO-REPUBLIQUE KOSOVËS  
OPŠTINA ŠTRPCE-KOMUNE DE SHTËRPÇËS  
IZLAZNI - DALEŽE  
01- Prot. Nr. f. rot. 01-020/08-6804/22  
Br.str. /  
Nr.i fq. /  
Datum 27.05.2022.  
Data ŠTRPCE - SHTËRPÇË

Në mbështetje të neneve 12 17 dhe 40 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, të neneve 10 dhe 34 dhe 28 të Statutit të Komunës së Shtërpçës 01-Nr 898 të datës 14/07/2010, Kuvendi i Komunës së Shtërpçës në mbledhjen e mbajtur më datën 25.05.2022 shqyrtoj vlerësimin e ligjshmërisë se Ministrisë se Mjedisit, Planifikimit Hapësinor nr. 2520-3/22 te datës 22.05.2022 lidhur me vendimin e komunës se Shtërpçës nr.01-020/08-5414/22 lidhur me pagesën e taksës hyrëse ne parkun nacional ne zonën e skijimit ne Brezovice dhe pas debatit te zhvilluar, paraqet kete:

#### KERKESE

Kërkojmë nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor qe ne bashkëpunim me Komunën e Shtërpçës te gjejnë mundësin e heqjen e taksës për veturat për hyrjes ne parkun nacional ne zonën e skijimit ne Brezovic per qytetaret e komunës se Shtërpçës.

#### Arsyetim

Duke marre për baze kërkesat e vazhdueshme te qytetareve te komunës se Shtërpçës te cilët kan kërkuar qe te ndërmarrën veprime qe te ti dalin ne ndihmë lidhur me pagesën e taksës ne fjale.

Duke marre për baze gjendjen e dobët ekonomike te qytetareve te komunës se Shtërpçës te cilët janë te lidhur dhe mishëruar me qendrën e skijimit ne Brezovice për arsyte biznesit dhe rekreacionit si dhe faktin se si qytetar te kësaj komune si banore rezident krijojnë shpenzime rreth vizitës ne qendrën e skijimit

Kryetari i komunës se Shtërpçës ka shpreh gadishmerin për bashkëpunim me MMPH për tu dalë ne ndihme qytetareve te komunës se Shtërpçës dhe se ne vazhdimësi edhe ne takime zyrtare me organet përgjegjëse si dhe kërkesave ka kërkuar mirëkuptim për heqjen e taksës për qytetaret e komunës se Shtërpçës.

Gjithashtu kryetari i komunës ne mbledhjen e kuvendit te komunës se Shtërpçës ka kërkuar përkrahjen edhe te këtij kuvendi si organ me i larte i qeveris lokale lidhur me ketë iniciativë.

*Po te njëjtën mbledhje kuvendi i komunës ka marre vendim te mbështet iniciativën e Kryetarit te Komunës lidhur me heqjen e taksës për veturat për hyrjes ne parkun nacional ne zonën e skijimit ne Brezovic per qytetaret e komunës se Shtërpçës dhe ka kërkuar nga Kryetari i komunës qe te ndërmerr te gjitha veprimet e nevojshme qe ne bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës te mundësoj heqjen e kësaj takse*

Komuna e Shtërpçës konform legjislacionit ne fuqi ka dërguar kete vendim për vlerësimin e ligjshmërisë.

Vlerësimi i ligjshmërisë se këtij akti te kuvendit te komunës është bere sikur gjoja kuvendi i komunës “*ka marre vendim qe te heq taksen*” ne fjalë gjë qe nuk përkon me realitetin ngase vetëm është kërkuar nga Kryetari i Komunës qe ne bashkëpunim me MMPH te mundësoj heqjen e kësaj takse e jo si qeshte interpretuar me aktin e vlerësimit te ligjshmërisë.

Realisht ky vendim ne esencën dhe përbajtjen e tij ka pikërisht atë qe është përshkruar ne aktin e vlerësimit te ligjshmërisë ku thuhet se Komina mund te kërkoj nga MMPH qe përmes përfaqësuesve te saje te kërkoj heqjen e kësaj takse për qytetaret e komunës se Shtërpçës.

Andaj duke dashur qe te kemi bashkëpunim dhe mirëkuptim ne mes institucioneve Kuvendi i Komunës rishikoj vendimin sipas kërkesës se aktit për vlerësimin e ligjshmërisë dhe vendosi qe te paraqes ketë kërkese siç edhe është rekomanduar me shpresën se do te ketë mirëkuptim dhe bashkëpunim për zgjedhjen e këtij shqetësimi për qytetaret e komunës se Shtërpçës

Me respekt

